





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT  
SEKTORI I ASISTENCËS DHE SHËRBIMIT**

Nr. 78 824 Prot.

Tiranë, më 24.04.2019

Lënda: Kthim përgjigje

**AV. VASILIKA HYSI**

**Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Rruga "Nikolla Jorga", Kulla nr.8 Pallati Begeja,  
Nr.5, kati 5, Ap 23, Tiranë**

Në përgjigje të kërkesës tuaj, protokolluar me nr. 7892 Prot., datë 15.04.2019 në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, bazuar në ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e Informimit", regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 118, në të cilën kërkonti të informoheni në lidhje me subjektet e strukturës organizative të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, që kanë detyrim të deklarojnë pasurinë, të ardhurat e tyre dhe të familjes, si dhe bazën ligjore për këto subjekte, pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të Ligjit të sipërcituar, ju informojmë se informacioni i kërkuar nuk disponohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Gjithashtu, Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, në nenin 24 dhe 25, përcakton në mënyrë të qartë autoritetet dhe rrethanat, të cilave Administratat Tatimore mund dhe duhet t'iu ofrojë, pas kërkesës me shkrim, informacion tatimor për tatimpaguesit, të administruar prej saj dhe konkretisht citojmë: "*Informacioni tatimor për tatimpaguesin, i administruar nga administrata tatimore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:*

- a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;
- b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;

- c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta;
- ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes;
- d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit;
- dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj;
- e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë.”

Detyrimi ligjor për të ruajtur konfidencialitetin e të dhënave të administruara është parashikuar saktësisht edhe nga neni 31, i ligjit të sipërcituar, i cili thekson se: “çdo tatimpagues ka të drejtën e konfidencialitetit për të dhënat e veta tatimore e financiare, të administruara nga Administrata Tatimore”.

Administrata Tatimore, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, është një institucion ekzekutues dhe zbatues dhe që udhëhiqet nga parimi për zbatimin e njëjtë dhe efektiv të legjislacionit për të gjithë tatimpaguesit, parashikuar shprehimisht nga neni 12/a) i Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar.

**ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Xhavit Çurri**



